



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

ZYRA E PERMBARIMIT PRIVAT EPSA



Nr. 3422 Prot

Tiranë, më 27.10.2020

Nr 667 Dosje

URDHËR

(PËR HEQJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE NGA KUOTAT/AKSIONET)

Drejtuar : QENDRES KOMBETARE TE BIZNESIT

TIRANË

Unë **Gelas YZO** përmbarues gjyqësor pranë Zyres së Permbarimit Privat "EPSA" shpk, në referim të "Urdhërit të Ekzekutimit" Nr.2725 Akti date 03.04.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane , kam vënë në ekzekutim këtë *Urdhër*, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 667 date 28.05.2012, kërkesën e kreditorit "**Banka Intesa SanPaolo Shqiperi**" Sha me objekt ekzekutimin e titullit ekzekutiv, Kontrates së Kredise Bankare me Nr.3211 Rep. Nr.438 Kol, datë 07.11.2007 e amenduar me Kontraten Nr.1460 Rep 1018 Kol date 31.07.2015 me pale debitore **Shoq "Wind Co"** shpk dhe dorezanes **Brunilda Koka**.

Me përmbushjen konform ligjit të të gjithë hapave të parashikuara dhe të kërkuara proceduriale, si edhe me përfundimin e afatit të fundit të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm, parashikuar në nenin 567 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA

Me shkresën Nr.20/38983 Prot date 23.10.2020, pala kreditore "**Banka Intesa SanPaolo Shqiperi**" Sha ka kërkuar pushimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv pasi debitori ka shlyer detyrimet ndaj kreditorit.

**Përsa më sipër, në referim të nenit 616 të K.Pr.Civile si dhe të Ligjit Nr. 26/2019 “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”,**

**URDHËROJ**

1. Qendra Kombëtare e Biznesit, të bëjë heqjen e sekuestros konservative, e vendosur me shkresën Nr. 4116 Prot date 25.06.2018 të shoq. EPSA, nga kuotat/aksionet shpk në pronësi të debitorëve :
  - **Shoq. “Wind Co” shpk, NIPT K12015501N**, me seli në L.1, Koder Vile, Durrës, me përfaqësues ligjor Brunilda Koka.
  - **Brunilda Koka**, atësia : Naim, dtl: 15.09.1968
2. Për informimin, bllokimin dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorët e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
3. Personat që bëhen pengesë, apo të cilët i paraprijnë ndonjë ndryshimi të mundshëm të pronësisë së mjeteve të luajtshme në emër të debitorëve të përmendur në pikën 1, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive.
4. Ky urdhër mbahet në 5 (pesë) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

**ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT “EPSA” SHPK**

Përmbartuesi GJYQËSOR

**GELAS YZO**

